

Radio RINIA
Adem LIMANI
Drejtor
Gjilan

Ankesa Nr. 2017/25 KPM vs Radio RINIA
Ref:1708/797/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/25 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Radio RINIA (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur më Licencë të KPM-së me datën 6 tetor 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM me datën 16 janar 2017 ka pranuar një ankesë nga Radio Star lidhur me interferencat e shkaktuar në frekuencën 96.4 MHz nga transmetimi i sinjalit të Radio Gjilani dhe Radio Rinia në frekuencën 93.5 MHz.
3. KPM me datën 16 janar 2017, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, ka bërë vizitë në terren dhe gjatë verifikimit të sinjalit të transmetimit dhe mbulueshmërisë së Palës Përgjegjëse, ka gjetur se nuk është duke transmetuar në frekuencën 98.4 MHz, për të cilin është licencuar nga KPM-ja, dhe se është duke shkaktuar interferencia në tërë brezin frekuencor FM. Dhe se Pala Përgjegjëse është duke interferuar në frekuencën e Radio Star 96,4 MHz.
4. KPM me datën 18 janar 2017, duke u bazuar në raportin e KPM-së, përmes një letre ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që në afat prej shtatë (7) ditësh të verifikojë punën e sistemit të transmetimit, duke përfshirë edhe atë të filtrit dalës të transmetuesit, duke u siguruar që të ndërpriten ndërhyrjet e shkaktuara nga sinjali i transmetimit të Radio Rinia, me qëllim që të veprojë në pajtim me parametrat teknik të përcaktuar me Pjesën 2 dhe 4 të Licencës.
5. KPM me datën 3 shkurt 2017 përmes një shkrese është njoftuar nga Pala Përgjegjëse se kinse kanë angazhuar persona teknik për zgjidhjen e problemit me ndërhyrjet dhe sipas kësaj shkrese Pala Përgjegjëse nuk është duke shkaktuar ndërhyrje në brezin frekuencor.

6. KPM me datën 27 shkurt 2017, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, ka bërë edhe një monitorim tjetër dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër letrës të datës 18 janar 2017, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke mos e instaluar filtrin dalës në transmetues, i cili është kusht teknik për licencim. Gjatë monitorimit është konstatuar se ka edhe probleme me sistemin e transmetimit, duke shkaktuar ndërhyrje të theksueshme në brezin frekuencor në atë zonë të mbulimit. Pala Përgjegjëse ka dështuar të ndërmarrë masat e duhura teknike për të vepruar në pajtueshmëri të plotë me Kushtet dhe Termet e përgjithshme të Licencës së KPM-së.
7. KPM me datën 9 mars 2017, duke u bazuar në raportin e Departamentit të Menaxhimit Frekuencor, përmes një letre ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që në afat prej shtatë (7) ditësh të verifikojë punën e sistemit të transmetimit, duke përfshirë edhe atë të filtrit dalës të transmetuesit, duke u siguruar që të ndërpriten ndërhyrjet e shkaktuara nga sinjal i transmetimit të Palës Përgjegjëse, me qëllim që të veprojë në pajtim me Kushtet dhe Termet Teknike të përcaktuara me pjesën 2 të Licencës.
8. KPM me datën 11 maj 2017, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, ka bërë edhe një monitorim tjetër dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër letrës së datës 9 mars 2017, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet Teknike të Licencës, duke mos evituar problemet në sistemin e transmetimit dhe duke vazhduar të shkaktojë interferencia në brezin frekuencor FM. Pala Përgjegjëse është e licencuar nga KPM-ja të transmetojë në frekuencën 98.4 MHz.

Analiza Ligjore

9. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Pjesës 2 të Licencës së KPM-së, Kushtet dhe Termet Teknike pika 18 dhe 26, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pjesa 2 e Licencës së KPM-së (Kushtet dhe Termet Teknike), në pikën 18 përcakton kufirin e devijimit të sinjalit.
10. Devijimi më i madh i lejuar i sinjalit për frekuencën e Palës Përgjegjëse, 98.4 MHz, të licencuar nga KPM sipas Kushteve dhe Parametrave Teknik të Licencës është (+-) 75 kHz. KPM, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka shkaktuar devijim të sinjalit të transmetimit jashtë këtij parametri, (+-)75 kHz, duke u dëgjuar nga frekuanca 97.5 MHz deri në frekuencën 99.4 MHz dhe duke shkaktuar interefenca në brezin radio FM (87.5 MHz-108 MHz).
11. Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapat e nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me pikën 18 të Kushteve dhe Termeve Teknike të Licencës, duke devijuar sinjalin e transmetimit jashtë parametrave të lejuara dhe duke shkaktuar në mënyrë të vazhdueshme ndërhyrje në brezin radio FM (87.5 MHz-108 MHz).
12. KPM gjithashtu ka gjetur së Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim edhe me pikën 26 të Pjesës 2 të Licencës "Kushtet dhe Termet Teknike", e cila përcakton obligimin e subjektit transmetues për të instaluar filtrin dalës të transmetuesit.


13. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër obligimit të përcaktuar në Kushtet e Licencës, ka dështuar të instalojë filtrin dalës të transmetuesit, duke vepruar kështu në mënyrë të vazhdueshme në kundërshtim me parametrat teknik të Licencës.
14. KPM bazuar në raportet e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër shkresave të dërguara nga KPM, përmes të cilave i është bërë me dije se është në shkelje të Kushteve dhe Termeve Teknike, ka dështuar të ndërprenë ndërhyrjet e shkaktuara nga sinjali i transmetimit dhe të instalojë filtrin dalës të transmetuesit, ashtu siç është e përcaktuar në pjesën e 2 të Licencës së KPM-së.
15. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, KPM, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të pikave 18 dhe 26 të pjesës 2 të Licencës së KPM-së, Kushtet dhe Termet Teknike.

Vendimi

16. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të pikave 18 dhe 26 të Pjesës së Dytë të Kushteve dhe Termeve Teknike të Licencës pasi që ka dështuar të ndërpresë ndërhyrjet e shkaktuara nga sinjali i transmetimit dhe të instalojë filtrin dalës të transmetuesit.
17. Komisioni kërkon nga Pala Përgjegjëse që të ndërpresë menjëherë ndërhyrjet e shkaktuara nga sinjali i transmetimit dhe të instalojë filtrin dalës të transmetuesit, ashtu siç është e përcaktuar me Kushtet dhe Termet Teknike të Licencës të KPM-së.
18. Dështimi i Palës Përgjegjëse për të vepruar menjëherë në pajtim me Kushtet dhe Termet Teknike të Licencës, do të rezultojë me pezullim të Licencës në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, pika 1.4., të Ligjit të KPM-së.
19. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të pikës 18 dhe 26 të pjesës 2 të Kushteve dhe Termeve Teknike të Licencës.

E drejta për Ankesë

20. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
21. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë